

FJALA E DEPUTETIT GAZMENT BARDHI

E ENJTE 17 NËNTOR 2022

Të dashur bashkëqytetarë,

Nuk është rastësi që kjo çështje të lihet sot, 5 muaj, pasi ne kemi paraqitur kërkesën në Kuvend, pikë e 10-të e rendit të ditës dhe të diskutohet ekzaktësisht në këtë orë të vonë të natës, në 12 të natës, një rast unik në botë, ku një anëtar i qeverisë gëzon statusin e investitorit strategjik. Ky parlament në vitin 2015 miratoi një ligj, gjoja për të thithur investime të huaja, por tashmë është fakt i njohur publik që u katandis në një listë me 34 investitorë, pjesa dërrmuese miq të Kryeministrit, secili prej tyre me 5 apo 6 projekte investimesh strategjike, ku nuk mungon edhe ministrja jonë e Jashtme, e cila ka marrë përsipër të drejtojë edhe procesin për të na çuar drejt Bashkimit Europian dhe me firmën e eprorit të saj të drejtpërdrejtë fiton statusin e investitorit strategjik.

Kjo anë e sallës së parlamentit ka marrë sot porosinë (në fakt, ndiej keqardhje për kolegët që janë kthyer thjesht në vullnetarë dhe vetëm votojnë) që Olta Xhaçkën t'ia fshehin Gjykatës Kushtetuese, sepse Kuvendi nuk ka kompetencë as të heqë dhe as të japë mandate. E vetmja kompetencë që ka Kuvendi është ta paraqesë çështjen në Gjykatën Kushtetuese. Pyetja ime për zotërinë, që sapo është kthyer nga Beogradi, është: pse e fshehe këtë rast dhe pse nuk e paraqet në Gjykatën Kushtetuese? Kemi një Gjykatë Kushtetuese të reformuar, që ka dalë nga reforma në drejtësi dhe askush prej nesh nuk duhet të ketë frikë. Madje duhej të ishte interesi i Kryeministrit dhe i ministres së tij që çështja të shqyrtohet nga Gjykata Kushtetuese.

Çfarë shqetësimi keni ju që do ta pengoni dërgimin e kësaj çështjeje në Gjykatën Kushtetuese, që të njihen qytetarët me rastin unik nën botë, ku ministri për Punët e Jashtme dhe Europën gëzon edhe statusin e investitorit strategjik dhe bashkë me bashkëshortin do të investojnë 5,5 milionë euro? Ndërkohë që e kam thënë këtu në qershor që bashkëshorti, njësoj si shtresat në nevojë, kishte marrë pagesë nga Covid-i. Pra, ishte pjesë e shtresave që morën pagesë papunësie gjatë periudhës së Covid-it dhe sot na del që ka një kapital për të investuar 5,5 milionë euro. Ligji "Për investimet strategjike" është miratuar më 28 maj 2015 dhe ka hyrë në fuqi më 17 tetor 2015. Menjëherë pas hyrjes në fuqi të ligjit, konkretisht në datën 21 tetor 2015, një deputet i këtij Kuvendi, që kishte votuar ligjin për investimet

strategjiken, krijoi shoqërinë tregtare “AG. TCC” sh.p.k., me objekt veprimtarie investime në hoteleri-turizëm, në kundërshtim flagrant me ligjin për konfliktin e interesit.

Kjo kompani, në pronësi të deputetit në atë kohë, zotit Artan Gaçi, i cili është administrator dhe ortak i vetëm i saj, rezulton se aplikon edhe për marrjen e statusit të investitorit strategjik. Kompania është krijuar menjëherë pas miratimit të ligjit “Për investimet strategjike”. Ky, që është këtu lart, u thoshte qytetarëve se Artan Gaçi po votonte një ligj që të thithte investime të huaja strategjike. Në fakt, Artan Gaçi dhe bashkëshortja e tij po votonin në vitin 2015 një ligj, që të fitonin vetë statusin e investitorëve strategjikë. Meqenëse ky krahu këtej e ka shtyrë afatin për zbatimin e ligjit në vitin 2023, bëni edhe ju, njësoj si Olta, aplikoni te zotëria atje lart dhe përfitoni statusin e investitorit strategjik. Pse duhet të ketë status të veçantë Olta Xhaçka?

Çfarë dallimi ka Olta Xhaçka nga secili prej jush? Aplikoni edhe ju; vetë e keni miratuar ligjin dhe përfitoni statusin e investitorit strategjik, sepse nuk ka asnjë dallim midis një deputeti dhe një deputeti tjetër. Aplikoni edhe ju; nxitini familjarët tuaj. Mos e lini Kryeministrin t’ia japë 5 projekte një oligarku, por aplikoni edhe ju; nxitini familjarët tuaj të aplikojnë dhe ju të merrni statusin e investitorit strategjik. Kompania në pronësi apo në bashkëpronësi të ministres, me vendimin nr. 3/5, datë 29.03.2021 “Për miratimin e statusit “investim/investitor strategjik, procedurë e asistuar”” ka përfutur një projekt për ndërtimin e një hoteli disakatësh me 5 yje në një sipërfaqe zhvillimi prej 10,592 m<sup>2</sup> dhe me vlerë rreth 5,5 milionë euro në Himarë.

Ndër të tjera, vendimi i Komitetit të Investimeve Strategjike parashikon masat lehtësuese që përfiton kompania në pronësi të bashkëshortit të ministres dhe, në kuptim të Kodit të Familjes, edhe të vetë ministres dhe deputetes, Olta Xhaçka. Në përputhje me vendimin e Komitetit të Investimeve Strategjike nr. 3/5, datë 29.03.2021, shoqëria, në pronësi të bashkëshortit të ministres dhe deputetes, zonjës Olta Xhaçka, ka përfutur masën mbështetëse të lejit të përdorimit të bregut para hotelit për një periudhë 30-vjeçare. Sipas vendimit, shoqëria investuese synon që zonën e bregdetit ta përdorë ekskluzivisht për zhvillimin e veprimtarisë turistike në shërbim të hotelit që po zhvillohet.

Për këtë qëllim, në këtë zonë planifikohet të instalohen disa stacione plazhi, ku synohet të ofrohet shërbimi i cilësisë së lartë, thotë vendimi i firmosur nga vetë Edi Rama, në përputhje edhe me standardet ndërkombëtare. Për këtë arsye, por edhe me qëllim që subjekti investues të përfitojë nga reduktimi i tatimit mbi vlerën e shtuar, sipas pikës 2, neni 11/1 i VKM-së nr. 953/2014, subjekti investues ka krijuar një shoqëri të dedikuar. Konkretisht, në datën 25.06.2021 një shtetase amerikane, e lindur në

vitin 1990, që rezulton të jetë bashkëjetuesja e vëllait të ministres, ka krijuar një kompani tjetër me kapital prej 500 milionë lekësh, me objekt veprimtarie “shërbim hoteleri- turizëm”.

5 ditë pas krijimit nga kunata e ministres, ajo ka nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi me shoqërinë “AG.TCC” sh.p.k., në pronësi apo bashkëpronësi të ministres dhe bashkëshortit të saj për administrimin e pasurisë publike, që ky i fundit ka fituar si investitor strategjik, pra brigjeve të detit dhe plazhin në zonën e Himarës. Aktualisht, shoqëria investuese “AG.TCC” sh.p.k. ka lidhur një marrëveshje bashkëpunimi nr. 695, datë 30.06.2021, me shoqërinë në bashkëpronësi të ministres për operimin e strukturave turistike në projektin e ndërtimit të hotelit me 5 yje, ku përfshihet edhe operimi i stacioneve të plazhit në bregun përballë hotelit, duke luajtur kështu rolin e shoqërisë së dedikuar. Kjo marrëveshje vetëm 15 ditë më vonë, në datën 15 korrik 2021, reflektohet në një tjetër vendim të firmosur po nga Edi Rama, ku ndryshohet subjekti që gëzon statusin e “investim/investitor strategjik”, duke u kualifikuar në këtë rast pikërisht shoqëria e dedikuar.

Në vijim të procedurës, me vendimin nr. 137, datë 2 mars 2022, “Për lejimin e përdorimit të brigjeve dhe të zonës përkatëse të plazhit përballë kompleksit”, vendim i firmosur po nga Edi Rama, kësaj here në cilësinë e Kryeministrit, pra vendim i Këshillit të Ministrave, Këshilli i Ministrave ka konkretizuar dhënien e të drejtës së përdorimit të brigjeve të detit dhe të zonës përkatëse të plazhit për shoqërinë investuese, në bashkëpronësi të ministres dhe deputetes Olta Xhaçka dhe bashkëshortit të saj, duke detyruar Bashkinë e Himarës të lidhë kontratën me ta.

Konkretisht, sipas vendimit të firmosur nga eprori i ministres, Kryeministri Edi Rama, Bashkia e Himarës ka detyrimin që, brenda 15 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës së investitorit strategjik, të lidhë kontratën përkatëse për lejimin e përdorimit të brigjeve të detit dhe të zonës përkatëse të plazhit përballë kompleksit, në përputhje me sipërfaqet dhe destinacionin e kërkuar nga subjekti investues, i lejuar sipas vendimit të Komitetit të Investimeve Strategjike, i firmosur nga eprori i ministres, Kryeministri Edi Rama, dhe i konfirmuar më tej nga Bashkia e Himarës. Dhënia e pasurisë publike për qëllime fitimi dhe ushtrimi të veprimtarive fitimprurëse, është bërë në shkelje flagrante të ndalimeve kushtetuese dhe ligjore, që ndalojnë një deputet, për efekt të ligjit, bashkëshortin e tij, të përfitojë pasuri të shtetit apo të kryejë veprimtari fitimprurëse që burojnë nga pasuritë e shtetit.

Ky fakt përbën shkelje të rëndë të ligjit, që më pas sjell mbarimin apo pavlefshmërinë e mandatit të deputetit, sipas nenit 71 të Kushtetutës. Parashikimi nga kushtetutëbërësi i rasteve të papajtueshmërive, që lidhen me mandatin e deputetit, përbën një garanci për respektimin e parimit të

ndarjes së pushteteve, pavarësisë në ushtrimin e mandatit parlamentar, si dhe shmangien e konfliktit të interesit. Ndërsa, sipas pikës 2 të nenit 70, Kushtetuta jonë ua ka deleguar ligjeve të posaçme rastet e papajtueshmërisë. Në pikën 3 të kësaj dispozite ka preferuar të vendosë ndalimin në rang kushtetues dhe ta cilësojë si të papajtueshëm me funksionin e deputetit ushtrimin e aktivitetit fitimprurës prej tij, kur të ardhurat nga ky aktivitet burojnë nga pasuri të shtetit.

Ky ndalim është i shprehur qartë dhe pa asnjë ekuivok nga kushtetutëbërësi, i cili ka pasur si qëllim eliminimin e plotë të shkaqeve për ta konsideruar funksionin e deputetit si një mundësi të mirë për të shtuar burimin e të ardhurave private nëpërmjet pozitës së favorshme që ka ai si anëtar i organit më të lartë përfaqësues. Nëse deputeti, përveç pagës që do të merrte si i tillë, do të mund të merrte edhe të ardhura të tjera nga buxheti i shtetit apo veprimtari fitimprurëse, që burojnë nga pasuria e shtetit, atëherë do të cenohet dispozita kushtetuese. Kjo i shërben parimit të shërbimit sa më të mirë ndaj qytetarëve. Ligjet që miratojmë në Kuvend, nuk i miratojmë për të përfituar, por i miratojmë për të përfituar qytetarët.

Artan Gaçi dhe Olta Xhaçka në vitin 2015, kur kanë votuar ligjin, nuk kanë votuar që të përfitojnë ata, por kanë votuar që të përfitojnë investitorët strategjik, investitorë strategjikë të huaj apo shqiptarë. Në fund të fundit, përfitimi në kundërshtim me Kushtetutën do të cenonte edhe parimet e demokracisë, ku çdo funksionar publik duhet të ushtrojë me të gjitha forcat dhe energjitë e veta detyrën, për të cilën është zgjedhur ose është emëruar, detyrë, të cilën ai e ka pranuar me vullnetin e tij të plotë dhe të lirë. E kundërta mbart, natyrshëm, dyshime lidhur me besueshmërinë e publikut në cilësinë e përfaqësimit të tij.

Neni 70/3 i Kushtetutës, siç shprehet edhe Gjykata Kushtetuese në jurisprudencën e saj, nuk mund të lexohet i shkëputur nga përmbajtja e nenit 70 në tërësinë e tij, i cili, edhe pse në thelb ka qëllim shmangien e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike, për sa u përket rregullave, mjeteve, mënyrave, procedurave, përgjegjësisë dhe kompetencave për identifikimin, deklarimin, regjistrimin, trajtimin, zgjidhjen dhe dënimin e rasteve të konfliktit të interesit, referon në ligjin përkatës për parandalimin e konfliktit të interesit. Çfarë thotë ligji? Ligji nr. 9367/2005 parashikon shprehimisht në nenin 35 të tij se në rast se aksionet apo pjesët në kapital janë të regjistruara në emrin e bashkëshortit, ato vlerësohen njëjloj sikur të ishin të regjistruara në emër të vetë zyrtarit.

Për pasojë, në kuptim të ligjit dhe për efekt të zbatimit të ndalimit kushtetues/ligjor, shoqëria tregtare, që Kryeministri Edi Rama i ka dhënë statusin e investitorit strategjik, duke i vënë në dispozicion edhe

brigjet e detit, konsiderohet në pronësi të vetë ministres dhe deputetes, Olta Xhaçka. Për pasojë, përfitimet nga pasuria e shtetit, që burojnë nga vendimi nr. 3/5, datë 29.03.2021, janë përfitime edhe të ministres dhe deputetes, Olta Xhaçka. Kjo rrjedh natyrshëm edhe nga përcaktimet e Kodit të Familjes, konkretisht, në nenin 74 të Kodit përcaktohet se bashkësia e përbashkët, pra, pronësia e përbashkët mes bashkëshortëve, është pasuria e fituar nga të dy ata, së bashku, ose veç e veç gjatë martesës.

Nga kjo dispozitë deduktohet qartësisht se çdo pasuri e krijuar gjatë martesës, që i përket bashkëshortit të deputetes, zotit Gaçi, rrjedhimisht, 50% prej saj i përkasin investitores strategjike, ministres dhe deputetes Olta Xhaçka, përfshirë këtu edhe aksionet në shoqërinë tregtare "AG.TCC" sh.p.k., duke qenë se kjo e fundit është krijuar pas lidhjes së martesës. Kjo do të thotë se përfitimi nga ana e kësaj shoqërie e të drejtave mbi pasuritë e shtetit konsiderohet ekzaktesisht që është përfituar nga deputetja dhe ministrja Olta Xhaçka. Nga dokumentacioni bashkëlidhur dy mocioneve të depozituar nga pakica parlamentare rezulton e provuar se shoqëria tregtare ka përfituar të drejtën për të kryer veprimtari fitimprurëse, që burojnë nga pasuria e shtetit dhe pushtetit vendor, nëpërmjet ofrimit të shërbimeve në fushën e turizmit, në kohën kur Olta Xhaçka ushtron mandatin e deputetes.

Ky fakt bie ndesh me ndalimin kushtetues të parashikuar nga neni 70 i Kushtetutës dhe është tërësisht i mjaftueshëm për konstatimin e papajtueshmërisë së mandatit të deputetes Olta Xhaçka. Në vijim të fakteve dhe rrethanave të parashtruara jo vetëm në këtë seancë, por veçanërisht gjatë diskutimit të kësaj çështjeje në Këshillin e Rregullores dhe Mandateve është e qartë se deputetja dhe ministrja për Europën dhe Punët e Jashtme ndodhet në kushtet e papajtueshmërisë, të përcaktuar nga neni 70, pikat 2 dhe 3 të Kushtetutës së Shqipërisë. Megjithatë, ne sot nuk jemi për të vendosur nëse zonja Xhaçka është ose jo në kushtet e papajtueshmërisë së mandatit. Këtë e vendos një organ jashtë influencës së kësaj shkalle, që është Gjykata Kushtetuese, dhe pyetja e opozitës është: çfarë halli keni ju, që nuk e çoni këtë çështje në Gjykatën Kushtetuese, në kundërshtim flagrant me një vendim të Gjykatës Kushtetuese, me vendimin nr.7, datë 24.02.2016?

Nga ky vendim unë do të citoj vetëm dy paragrafë. Nuk është e drejta juaj, edhe pse ju ka urdhëruar zotëria i sapo kthyer nga Beogradi, për të vendosur nëse çështja duhet ose jo të shkojë përpara Gjykatës Kushtetuese, sepse e keni detyrim kushtetues ta çoni çështjen në Gjykatën Kushtetuese. Po ju lexoj se çfarë ka thënë Gjykata Kushtetuese: "Gjykata, në ndryshim nga sa pretendon Kuvendi, vlerëson se edhe pse në përmbajtje të pikës 4 të nenit 70 të Kushtetutës nuk është përdorur termi "është i detyruar", kjo nënkupton se vlerësimi në këtë rast nuk është në kompetencë të Kuvendit, por se vënia në lëvizje e

Gjykatës kërkon një vendimmarrje të këtij organi, i cili është produkt i seancës plenare, pas respektimit të procedurave parlamentare”.

Nëse do të pranohej një pushtet i tillë i pakufizuar i Kuvendit, atëherë parashikimi kushtetues do të zhvishej nga qëllimi i tij, gjë që do të përbënte një abuzim me pushtetin e shumicës dhe do të ishte në kundërshtim me parimin e ndarjes dhe të balancimit ndërmjet pushteteve. Institucionalizimi i pushtetit të pakicës parlamentare, i materializuar në të drejtën për të kërkuar vënien në lëvizje të Gjykatës Kushtetuese është bërë nga kushtetutbërësi me qëllim shmangien e qëndrimeve politike, thënë shkurt, të urdhrave politikë të Edi Ramës nga ana e shumicës parlamentare. Në rast se do pranohej një interpretim i ndryshëm i kësaj norme, atëherë pakica parlamentare do të diskriminohej në raport me shumicën parlamentare, për sa kohë që ushtrimi i së drejtës së saj kushtetuese, i garantuar në pikën 4 të nenit 70 të Kushtetutës, do të ishte në diskrecionin e shumicës parlamentare.

Për sa më lart, Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se për çdo shkelje të pikës 3 të nenit 70 të Kushtetutës, ku kërkohet konstatimi i papajtueshmërisë së mandatit të deputetit, Kuvendi është i detyruar (thotë Gjykata Kushtetuese) ta dërgojë çështjen në Gjykatën Kushtetuese, i cili është organi i vetëm që ka kompetencë për të shqyrtuar në themel çështjen. Në raste të tilla, hapësira e vlerësimit të Kuvendit lidhet vetëm me verifikimin e kriterëve formale, duke respektuar procedurën parlamentare të parashikuar në Rregulloren e Kuvendit.

Në fund unë e di që ju do ta rrëzoni mocionin ose dy mocionet e dorëzuara nga opozita, çështja do të çohet në Gjykatën Kushtetuese, pra, urdhri i tij nuk është se do të ketë një efekt, thjesht do ta vononi edhe një javë tjetër, por kërkesa do të dorëzohet nesër në mëngjes, çështja do të shkojë në Gjykatën Kushtetuese, fshiheni edhe për disa kohë investitorin strategjik tek Olta Xhaçka, por nuk do ta shihni dot në mënyrë përfundimtare, siç nuk do ta shihni dot abuzimin me ligjin e investimeve strategjike, që zotëria i sapo kthyer nga Beogradi ka bërë gjatë këtyre 5 vjetëve. Faleminderit!